

VENDIM
Nr. 111, datë 2.7.2020

MBI PLOTËSIMIN E KUSHTIT TË VENDIMIT NR. 80, DATË 4.5.2020 “MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË ‘ALPIQ ENERGY ALBANIA’ SHPK NR. 291, SERIA FK15, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 73, DATË 13.5.2015” DHE VENDIMIT NR. 81, DATË 4.5.2020, “MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË ‘ALPIQ ENERGY ALBANIA’ SHPK NR. 290, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 72, DATË 13.5.2015”

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gjerat “ç” dhe “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 4, pika 1, gjerat “d” dhe “e”, nenit 5, pika 1, gjerat “d” dhe “e”, dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.7.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 78/3 prot., datë 25.6.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e Shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., mbi plotësimin e kushtit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 80 dhe nr. 81, datë 4.5.2020,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 80, datë 4.5.2020 “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Alpiq Energy Albania’ sh.p.k., nr. 291, seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 73, datë 13.5.2015”, vendosi:

- Të rinovojë licencën nr. 291, seria F15, të shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.73, datë 13.5.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar vlefshmërinë nga data 14.5.2020.

- Shoqëria të plotësojë tërësisht kërkesat e nenit 9, pika 2, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, brenda një muaji nga përfundimi i gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

- Po ashtu, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 81, datë 4.5.2020, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Alpiq Energy Albania’ sh.p.k., nr. 290, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 72, datë 13.5.2015”, vendosi:

- Të rinovojë licencën nr. 290, seria T15, të shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 72, datë 13.5.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 14.5.2020.

- Shoqëria të plotësojë kërkesën e nenit 9, pika 2, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, brenda një muaji nga përfundimi i gjendjes së fatkeqësisë natyrore, të shpallur me vendimin e Këshillit të Ministrave.

- Në vijim të këtyre vendimmarrjeve me shkresën nr. 552/7 prot., datë 13.5.2020, u krye njoftimi i vendimit të rinovimit, pranë shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., duke i bërë me dije dokumentacionin e munguar, që konsiston në:

- Vërtetimet e lëshuara nga Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë, neni 9, pika 2, germa “d”.

- Shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 552/8 prot., datë 17.6.2020, ka paraqitur në ERE të gjithë dokumentacionin e konstatuar të munguar.

- Me plotësimin e këtij dokumentacioni, pika 2 e vendimeve të Bordit të ERE-s nr. 80, datë 4.5.2020 dhe nr. 81, datë 4.5.2020 rezulton e plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr. 80, datë 4.5.2020 “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Alpiq Energy Albania’ sh.p.k. nr. 291, seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s, nr. 73, datë 13.5.2015”, shfuqizohet.

2. Pika 2 e vendimit nr. 81, datë 4.5.2020, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Alpiq Energy Albania’ sh.p.k., nr. 290, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 72, datë 13.5.2015”, shfuqizohet.

3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë shoqërinë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti